A3 _ DRAFT KONTRATË FURNIZIMI

Nr. i Referencës së Kontratës: <numër>

<Emri i plotë dhe adresa e autoritetit kontraktor>

("Autoriteti kontraktor"),

nga njëra palë,

dhe

<Emri i plotë zyrtar i kontraktorit>
<Adresa e plotë zyrtare>
<Numri i NIPT-it>
<Përfaqësuesi i autorizuar>, ("kontraktori")

nga pala tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KONTRATE

Neni 1: Objekti

1.1. Objekti i kontratës do të jetë [furnizimi], [dorëzimi], [shkarkimi], [vendosja dhe instalimi] i furnizimeve siç përshkruhen në Specifikimet Teknike (Aneksi III) bashkëlidhur kësaj kontrate.

1.2. Vendi i pranimit të furnizimeve do të jetë <vendosni vendin>, afatet për dorëzim do të jenë <vendosni datën> dhe Incoterm-i i zbatueshëm do të jetë "Dorëzuar me Detyrime të Paguara" (DDP).

1.3. Garancia e mallrave të furnizuara duhet të mbetet e vlefshme për një periudhë prej të paktën <numër> ditësh kalendarike pas datës së pranimit të përkohshëm.

1.4. Periudha e zbatimit të detyrave do të jetë <numër> ditë kalendarike duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.

1.5 Kontraktori do të respektojë në mënyrë strikte kushtet e specifikimeve teknike (Aneksi III) dhe ofertës teknike (Aneksi IV).

Neni 2: Origjina

2.1. Të gjitha mallrat e blera mund të kenë origjinë nga çdo vend, siç përcaktohet në nenin 10 të Kushteve të Veçanta.

Neni 3: Çmimi

3.1 Çmimi i furnizimeve do të jetë ai i paraqitur në ofertën financiare (Aneksi V). Çmimi maksimal total i kontratës do të jetë EUR <shuma>.

3.2 Pagesat do të kryhen në euro (EUR), në përputhje me nenet 26 deri 28 të Kushteve të Përgjithshme dhe Kushteve të Veçanta.

Neni 4: Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1. Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas rendit të përparësisë:

- dokumenti i kontratës;
- kushtet e veçanta (Aneksi I);
- kushtet e përgjithshme (Aneksi II);
- specifikimet teknike (Aneksi III);
- oferta teknike e kontraktorit (Aneksi IV);
- oferta financiare e kontraktorit (Aneksi V);
- formularët përkatës dhe dokumentet e tjera (Aneksi VI);

4.2. Dokumentet e ndryshme që përbëjnë kontratën do të konsiderohen se shpjegojnë reciprokisht njëri-tjetrin; në rast paqartësie ose mospërputhjeje, do të mbizotërojnë sipas rendit në të cilin paraqiten më sipër.

Neni 5: Kushtet specifike të zbatueshme për kontratën

5.1. Çdo komunikim me shkrim ndërmjet Palëve do të jetë në anglisht ose shqip dhe do t'u dërgohet personave të kontaktit dhe në të dhënat e kontaktit të përcaktuara më poshtë:

Për autoritetin kontraktor	**Për kontraktorin**
<Emri i autoritetit kontraktor>	<Emri i kontraktorit>
<Adresa e autoritetit kontraktor>	<Adresa e kontraktorit>
<Emri i përfaqësuesit të autorizuar>	<Emri i përfaqësuesit të autorizuar>
<Email-i i përfaqësuesit të autorizuar>	<Email-i i përfaqësuesit të autorizuar>
<Telefoni i përfaqësuesit të autorizuar>	<Telefoni i përfaqësuesit të autorizuar>

5.2. Kushtet e tjera specifike të zbatueshme për kontratën do të jenë ato të përcaktuara në Aneksin I bashkëlidhur.

Neni 6: Dispozita të tjera

6.1. Kjo marrëveshje do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar, marrëveshja përkatëse e financimit dhe rregulloret/udhëzimet e brendshme të YSBB-së.

6.2. Anekset e mëposhtme të Kontratës do të përbëjnë pjesë përbërëse të saj:

Aneksi I - kushtet e veçanta;
Aneksi II - kushtet e përgjithshme;
Aneksi III - specifikimet teknike;
Aneksi IV - oferta teknike;
Aneksi V - oferta financiare;
Aneksi VI - formularët dhe dokumentet e tjera.

***

Kjo Kontratë përgatitet në dy kopje, një për autoritetin kontraktor dhe një për kontraktorin.

***

Për autoritetin kontraktor	**Për kontraktorin**
Emri: _____	Emri: _____
Pozicioni: _____	Pozicioni: _____
Firma: _____	Firma: _____
Data: _____	Data: _____